

Gjergj Fishta and China – in connection with the poem *Casus Belli* in the collection *Ânzat e Parnasit*.

Abstract: In the second half of the 19th century China was weakened due to the Opium War and to the Japanese aggression of 1894-1895. In these circumstances the imperialist powers of the time such as Great Britain, France, Russia and Japan had divided China up into areas of their influence. They would plunder the wealth of the country and interfere in the home affairs. The foreigners would also despise ancient Chinese traditions and go unpunished, as they enjoyed immunity in the country and no legal action would be taken against them.

Such situation fuelled hatred and soon what history has labelled as the Boxer Rebellion (1898-1901) broke out. In that time Albania was under the Ottoman rule but the ideals of liberty forwarded by the League of Prizren and, more generally speaking, by the Albanian Awakening, had by now encouraged the Albanians, who aspired to live and prosper in an independent country. To the Chinese events, Fr Gjergj Fishta (1871-1940) devoted a whole poem by the title *Casus Belli* (in *Anzat e Parnasit*, 1907), with 29 stanzas of four verses each.

Conceived as a dialogue, the poem begins with the ambassadors of the European Powers reporting on the news followed then by the mighty ones from Europe who attempt to justify their military intervention in China triggered off by the assassination of the German ambassador at the hands of the Chinese rebels.

The poem conveys sentiments of deep empathy with China, with its riches and pristine nature, as well as with the Chinese – hardworking, intelligent and righteous people, to the point that one might think that the Poet had spent no little time in the midst of such people and their habitat.

Fishta's poem comes across as very interesting because of its form, vocabulary and expressions used (it was the beginning of the 20th century). It is also of a special interest if considered the capability to portray people and their inner world.

At the same time, the poem witnesses traditional empathy of the Albanians with China and its people.

Keywords: *China, Boxer Rebellion, Albanian Literature, Gjergj Fishta, poem, Casus Belli.*

Në gjysmën e dytë të shek. XIX Kina ishte e dobësuar shumë nga Lufta e Opiumit¹ dhe agresioni japonez i viteve 1894–1895. Në këto rrethana fuqitë imperialiste të kohës, Anglia, Gjermania, Franca, Rusia, Japonia, e kishin ndarë Kinën në zona influence (fig. 1), grabisnin pasuritë e saj, ndërhyenin në punët e brendshme, merrnin nëpër këmbë zakonet dhe rregullat shekullore të jetesës së kinezëve dhe mbeteshin pa u ndëshkuar, sepse të huajt kishin imunitet dhe nuk mund të procedoheshin në gjyqet e Kinës. Të gjitha këto ngjallën zemërim të thellë te populli kinez, që u ngrit në një revoltë të fuqishme, e cila njihet në histori si Kryengritja e Boksierëve (Boxer Rebellion) 1898–1901.

Në atë kohë Shqipëria gjendej nën sundimin e Perandorisë Osmane, por idetë çlirimtare të Lidhjes së Prizrenit (1878–1881) dhe të Rilindjes Kombëtare kishin ndezur zemrat e shqiptarëve, që dëshironin të jetonin e të qeveriseshin vetë pa të huaj në vatër. Prandaj edhe për shkrimtarët shqiptarë luftërat për liri e për vetëqeverisje të popujve të tjerë, sado që mund të ndodhnin në vende shumë të largëta gjeografikisht, ishin shumë të afërta emocionalisht. Kishin kaluar vetëm 20 vjet nga Kongresi i Berlinit dhe ishin ende të gjallë kujtimi dhe jehona e luftërave të organizuara nga Lidhja e Prizrenit për mbrojtjen e trojeve shqiptare të shkëputura me vendimet e atij Kongresi.

Ngjarjeve të Kinës në kapërcyell të shekullit XX (Kryengritja e Boksierëve²) Gjergj Fishta u kushtoi një vjershë të tërë, “Casus belli”³ (e përfshirë në vëllimin *Ânzat e Parrnasit*, 1907)⁴. Nga vargjet *Prandëju çuene / sivjet Bokserët ...* kuptohet se vjersha është shkruar në vitin e parë të shpërthimit të kryengritjes, d.m.th. më 1898. Atëherë Gjergj Fishta ishte vetëm 27 vjeç dhe ndodhej në atdhe. Po në këtë libër gjendet edhe vjersha “Lum i forti”, me të cilën poeti ynë stigmatizon Anglinë që kishte nisur luftën e dytë kundër popullit të vogël të Boerëve⁵ (1899–1902) në Afrikën e Jugut, i cili kundërshtonte me armë e me vendosmëri lakmitë imperialiste të Mbretëreshës së Detrave, siç quhej Anglia në atë kohë.⁶

Vjersha “Casus belli” ka 29 strofa me nga katër vargje dhe është e ndërtuar në formën e një dialogu: në fillim (18 strofa) raportojnë *Lajmtarët*⁷ (ambasadorët) e fuqive europiane në Kinë dhe në pjesën e dytë Europa (mbretërit dhe të pushtetshmit e fuqive) arsyeton vendimin për të ndërhyrë në Kinë me ushtri, duke pasur si *casus belli* vrasjen e ambasadorit gjerman nga kryengritësit (“boksierët”) kinezë. Kanë mbetur në histori fjalët e Kajzerit Wilhelm II, kur përcolli në portin e Bremenit kontingjentin gjerman për në Kinë, duke u kujtuar ushtarëve të tij se ashtu siç kanë hyrë në histori e në legjendë Hunët e Atilës (që shkretuan Evropën) një mijë vjet më parë, në të njëjtën mënyrë duhet të silleni dhe ju, që emri “gjerman” të kujtohet në Kinë për një mijë vjet të tjerë.

Një koalicion i përbërë nga fuqitë europiane të kohës: Britania e Madhe, Gjermania, Franca, Rusia, Austro-Hungaria dhe Italia, të cilave iu bashkuan edhe Shtete e Bashkuara të Amerikës dhe Japonia, mësynë Kinën, me një fuqi ushtarake prej 54 luftanijesh, rreth 5000 marinarë dhe 52.000 trupa të tjera. Forcat ushtarake të këtij koalicioni ndëshkimor bënë rrënimë, grabitje, tortura e vrasje të llahtarshme jo vetëm të kryengritësve që zinin rob, po edhe te popullsia civile. Këto fuqi e mbajtën të pushtuar një vit Pekinin, kryeqytetin e Kinës dhe i sollën fatkeqësi të mëdha popullit kinez.

Vjersha e Fishtës përshkohet nga një ndjenjë e sinqertë simpatie për Kinën me pasuritë e me bukuritë e saj natyrore (... *âsht një e bukur/ Mbretni e madhe/ Tanë mal i blerun,/ Fushë e livadhe*) dhe për Kinezët, njerëz punëtorë, të mençur e të virtytshëm (*Janë mjaft t'mëçem/ Kinezët e ngratë:/ Punen e dijen/ I kanë zanatë./ Kanë gjyqe t'mira, E dijn shka âsht besa, E der tash s'vonit/ S'kanë pasë ngatrrresa...*). Duke lexuar vjershën të duket sikur me të vërtetë Poeti ynë ka jetuar jo pak në mes të asaj natyre e të atyre njerëzve që i përshkruan sikur t'i kishte përpara syve. Por këtë mbarësi e begati gati idilike e dhunon politika grabitqare e fuqive europiane: *Por q'prej se hine/ N'Kinë Europejt/ Nuk janë tue shkue/ Bash punët fort drejt. Sepse shtetet imperialiste N'sÿ t'perparimit/ Janë msue m'ja vû/ Zgjedhen njerzimit. Kështu nis ndërhyrja ushtarake e tyre. Dhe si gjithnjë kur lufta ka si casus belli një njeri të vetëm, qëllimi i vërtetë mbulohet me demagogji: Me nisë n'Kinë luftën/ Mue nuk m'bjen keq/ Lkura e Gjermanitë/ Âsht halë n'perpeq;/ Veç shka: do t'thoni,/ Se këte ushtri/ E nisë Europa/ Veç për liri...*

Demagogjinë e fuqive europiane si sjellëse të lirisë e të përparimit Fishta e fshikullon edhe te pjesa e dytë e vjershës, ku flet për politikën e atyre fuqive ndaj Ballkanit.

Vjersha e Fishtës është interesante edhe nga thurja e saj, nga leksiku e nga frazeologjia e përdorur, nga figurat artistike, nga mjeshtëria e karakterizimit të personave e të psikologjisë së tyre. Kjo vjershë është njëkohësisht edhe një dëshmi historike e simpatisë së hershme të Shqiptarëve për Kinën dhe popullin e saj, gati gjysmë shekulli para se të shpallej solemnisht Republika Popullore e Kinës dhe të vendoseshin për herë të parë marrëdhënie diplomatike ndërmjet dy vendeve. Ajo i bën nder jo vetëm Poetit tonë të shquar të Rilindjes Kombëtare, po edhe letërsisë shqipe në tërësi, si dëshmi historike që shqiptarët kanë qenë gjithnjë në anën e popujve që luftonin për të drejtat e për dinjitetin e tyre kombëtar dhe kundër politikës grabitqare e poshtëruese të disa fuqive të kohës.

Shënimet:

- 1 Lufta e Opiumit (1840–1842): Ndërhyrje e armatosur e Anglisë kundër Kinës për ta detyruar të hapte portet e saj për të blerë opiumin e sjellë nga tregtarët anglezë, në një kohë kur në Kinë përdorimi i opiumit ishte i ndaluar nga shteti. Pas fitoreve ushtarake të anglezëve, falë epërsisë së flotës e të armatimeve, me traktatin e paqes që iu diktua, Kina u detyrua të hapte portet e saj për mallrat e tregtarëve anglezë dhe t'u jepte anglezëve ishullin e Hong-Kongut.
- 2 U quajt kështu sepse kryengritja u frymëzua dhe u nxit nga një rrjet organizatash të fshehta që quheshin “Grushti i drejtësisë dhe i harmonisë”. Anglezët, duke u nisur nga fjala *grusht*, filluan t'i quanin *boksierë* veprimtarët e këtyre organizatave dhe kështu emërtimi *Boxer Rebellion* u përhap në Perëndim, ndërsa në Kinë njihet si *Lëvizja Yihetuan* (義和團運動).
- 3 Shprehje latine me kuptimin: preteksti a arsyeja formale e nisjes së një lufte.
- 4 Nuk jam në dijeni për ndonjë botim të saj para këtij viti. Fjala *Ânzat* është forma e gegërishtes për *arrëzat* a *grerat*. Me këtë titull poeti paralajmëron satirat e forta politike që përmban libri. Vjersha *Casus belli* është pjesa e parë e vjershës së gjatë *Jus Gentium* (term i së drejtës romake me kuptimin “e drejta e popujve a e kombeve që nuk ishin qytetarë romakë”). Fishta këtu duket se e ka përdorur me kuptimin: e drejta e popujve jashtë fuqive që sundonin botën atëherë). Pjesa e dytë e vjershës mban titullin *Status quo*, përbëhet nga 39 strofa dhe ka si temë punët e Ballkanit në kapërcyell të shekullit XX. Ashtu si pjesa e parë (*Casus belli*) edhe kjo nis me raportimin e “Lajmtarëve”: *Europë, Ballkani/ Mbrapshtë është tue shkue,/ si flokë harapit/ Krejt është pshtjellue./ Do krajlakuklla/ Majmuna mbretash,/ Si edhe do knjaza/ T'shkundun kuletash ...* Pas përshkrimit të gjendjes së Ballkanit “Lajmtarët”, ashtu si edhe në rastin e Kinës, i kërkojnë Europës t'u çojë fjalë *Se a t'rijë Ballkani/ In statu quo* (d.m.th. të mbeten trojet shqiptare e të tjera nën sundimin e Perandorisë Osmane dhe nën kërcënimin e copëtimit, apo do të ndërhyhet që të rregullohet me drejtësi e në mënyrë të qëndrueshme çështja ballkanike dhe Ballkani të jetojë në harmoni e në paqe). Por *Europa s'ngjet,/ Ku e din se barra/ Qirán s'ia qet ...*, dhe përgjigjet përfundimisht: *Edhe Ballkani,/ Kshtu domosdo/ Atëherë do t'rijë,/ In statu quo. Por tash ju flëni/ Pse un larg do t'dal:/ Do t'çoj lirin/ Atje n'Transval ...* Të dyja pjesët e vjershës “Jus Gentium” janë një satirë politike therëse e Fishtës ndaj politikës së pamoralshme që ndiqnin fuqitë e mëdha të kohës që nga Kina në Azi, Transvali në Afrikë dhe Ballkani në Europë dhe që e mbulonin me demagogji sikur po çonin përparimin dhe lirinë. Me këtë Fishta u thotë shqiptarëve se nuk duhen mbajtur shpresat jashtë, por duhet vepruar e punuar brenda vendit për të përballuar rreziqet që i vinin Shqipërisë nga klientët e fuqive imperialiste në Ballkan.
- 5 Boerët – popullsi me prejardhje nga Holanda, e vendosur në Afrikën e Jugut gjatë shek. XVII. Në gjysmën e dytë të shek. XIX u formuan prej tyre dy republika autonome: e Oranzhit dhe e Transvalit, të quajtura edhe Republikat Boere.
- 6 Vjersha është ndërtuar në formën e një dialogu ndërmjet Inglizit dhe Boerit: i pari kërcënon: *Boer, ti a ndieve? qitma shpejt kuletën/ Me sa t'kesh pare, e s'ke pse lypë arsye...* I dyti e kundërshton me të madhe dhe i kujton se: *I Madhi Zot tha nierit tu'i dhanë jetën:/ Mos i ban kujë shka ty s'kish' me t'pëlqye...*, dhe i drejtohet Europës: *Ndihmom, Europë! Inglizit ç'faj un' pata?* Por Europa e vlerave të larta e ndan gjyqin me cinizëm: *Mos bzhjë tash, Boer, arsyeja rrin ke shpata.*
Për luftën e Boerëve kundër Anglisë ka shkruar edhe Çajupi (*Me Transvall lufton Anglia/ Shihni ç'punon Trimëria/ Lufton bualli me minë/ Transvalli lodhi Anglinë*) për t'u dhënë shqiptarëve një shembull të asaj që Noli do ta shprehte më pas te “Marathonomaku” me vargjet: *Se i vogli shtrin viganin/ dhe i shtypuri tiranin.*

- 7 Fjala *lajmtarët* këtu ka kuptimin e diplomatëve të fuqive të huaja në Kinë, të cilët u njoftonin qeverive e tyre gjithçka që kishin arritur të njihnin për Kinën dhe popullin e saj.
- 8 Është fjala për ambasadorin e Gjermanisë Baron von Ketteler, që u vra kur kryengritësit sulmuan lagjen e ambasadave në Pekin.

JUS GENTIUM

PJESË E PARË

CASUS BELLI

BISEDË

EUROPA E LAJMTARËT E SAJ

... *Et nos fas exera quaerere regna.* (Virg.)
Dhe ne duhet të kërkojmë një mbretëri të huaj.

LAJMTARËT

Europë, kjo Kina
Nuk është pallavra.
Porsi Siberia
Veç mal* e avra*;

Por është një e bukur
Mbretëri e madhe
Tanë mal i blerun,
Fushë e livadhe.

Ktû endet mndashi,
Qi s't'i del shoqi;
Ktû bín orizi
E kallamboqi;

Ktû bëhet gruni
Elbi e tershana,
Del edhe cehja*
E porçelana.

Ka edhe shumë gryka
Kah ana e bregut,
Qi per anë t'Lindjes
Jânë çilca tregut.

Besa, edhe njerëzit
Nuk janë fort t'kqí,
Si duen me thánun
Nji palë zotni:

Por janë mjaft t'mëçem
Kinezët e ngratë:
Punen e dijen
I kanë zanatë.

Kanë gjyqe t'mira,
E dijn shka është besa,
E der tash s'vonit
S'kanë pasë ngatresë.

Por q'prej se hîne
N'Kinë Europejt
Nuk janë tue shkue
Bash punët fort drejt.

T'bijt e Jafetit*
N'sý t'perparimit
Janë msue m'ja vû
Zgjedhen njerzimit.

Por se Kinezi
E ka n'merzi
Nder rraçe t'tija
Kush m'iu perzi;

Prandej u çuene
Sivjet Bokserët,
E me u hjekë qafet
Na lutne t'mjerët.

Por, mbasi e pane
Se na n'shpi t'huej,
Si t'ngulim thëmren,
S'ndigjojm mâ kujë*,
Besa t'u ngrehne
(E s'paten faj...)
Edhë t'na u lshuene
M'shpinë si çakaj.

Me mshrierë kineze*
M'né lane lesh*,
E porsí e lypem
Na bâne pshesh.

Nder sa Europeas,
Qi m'qafë i mueren,
Lajmi i Gjermanjes*
La i ngrati lkuren.

Per ketë t'pafatin,
N'mos daç per tjerë,
Shka t'bâjm, po t'pvesim
Tash, me Bokserë.

N' kjoftë casus belli
Ti na kallxó,
A se rrin puna
In statu quo.

EUROPA

Persë t'Gjermansit
I erdh exheli
Me lanë lëkurën,
S'âsht casus belli.

A niset lufta,
Tash, per një nieri?...
Por, ndal, pse u nguta:
Kam folë pa híri

Po thoni: Kina
Nuk âsht pallavra,
Porsi Siberia
Veç mal e avra;

Por âsht një e bukur
Mbretni e madhe
Tanë mal i blerun,
Fushë e livadhe...

Ka 'dhe shum gryka
Kah ana e bregut,
Qi per anë t'Lindjes
Janë çilca tregut...

Tash, ktû ndrron puna...
Ç'thotë Machiavelli?
Lkura e t'Gjermanit
Âsht casus belli!

Me nisë n'Kinë luften
Mue nuk m'bjen keq
Lkura e Gjermanit
Âsht halë n'perpeq;

Pse, po mund t'nguli
N'Pekin un kamen,
Kinës paçë m'ia shitun
Sa i biri t'amen.

Si t'ia njes doren,
Po e ziej çervishin:
S'rrij pa ia ndukun
Lkurën a mishin.

Prá, tash ju kputni
Me Kinë kornamet,
Pse kam me nisun
Atje donamet*.

Veç shka: do t'thoni,
Se këte ushtri
E nisë Europa
Veç për liri...

Shpjegim fjalësh të rralla:

mal – këtu me kuptimin 'pyll' (sipas gegërishtes veriore)

avër – *avra*: vend i hapër, hapësirë e gjerë e papunuar

cehe – *cehja*: minerale të ndryshme.

Jafeti: sipas Biblës njeri nga bijtë e Noes, prej të cilit rrjedhin popujt europianë; prandaj edhe gjuhët e Europës quhen shpesh *gjuhë jafetike*.

kujë: (këtu) askujt.

me mshrierë kineze: me mëshirë kineze (këtu: pa kurrfarë mëshire)

m'né lane lesh: lanë (folja laj) lesh mbi shpinat tona, d.m.th. na rrahën paq, na zhdëpën në dru.

Lajmi i Gjermanjes: ambasadori i Gjermanisë.

doname – *donamja*: anije lufte (turqisht).